



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ  
KESHILLI I BASHKISË**

Nr. \_\_\_\_ prot.

Maliq më 19.12.2017

**VENDIM**

**Nr.189, datë 15/12/2017**

**Për**

**“Miratimin e Paketës Fiskale për Vitin 2018”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, gërma (ç), Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Ligjit nr.9723 “Për Qendrën Kombetare të Regjistrimit”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 119, date 23.04.2009 “Për Planifikimin e territorit” i ndryshuar, Ligji nr.10 465 datë 29.09.2011 për “Shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr. 8378 dt 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Nr.9936 dt 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë,i ndryshuar, legjislacionit të aplikueshëm në fuqi, akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara, bazuar në relacionin e hartuar nga grupi i punës për përgatitjen e paketës fiskale për vitin 2018, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI :**

- I- Miratimin e Paketës Fiskale dhe Planit të të Ardhurave për vitin 2018.
- II- Efektet financiare me ndryshime fillojnë nga data 1 Janar 2018 e në vazhdim.
- III- Niveli i të ardhurave do të jetë sipas tabelave bashkëngjitur;
- IV- Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave dhe të gjitha strukturat e Bashkisë Maliq;
- V- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**ERISELD JONUSLLARI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ  
KËSHILLI I BASHKISË**

**PAKETA FISKALE PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të ligjit nr. 8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Ligji nr.9723 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, Ligji nr.10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e territorit” i ndryshuar, Ligji nr.10465 datë 29.09.2011 për “Shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Nr. 8378 dt 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Nr.9936 dt 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë,i ndryshuar, legjislacionit të aplikueshëm në fuqi, akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara, bazuar në relacionin e hartuar nga grupi i punës për përgatitjen e paketës fiskale për vitin 2018 e vijim me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak,

**VENDOSI :**

1. Të miratojë Paketën Fiskale 2018 për Bashkinë Maliq sipas materialit bashkëngjitur:

**I- TAKSAT VENDORE**

**Taksa mbi pasuritë e paluajtshme**

1. Taksa mbi ndërtesën
2. Taksa mbi truallin
3. Taksa mbi tokën bujqësore

**1. Taksa mbi ndërtesat**

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen, individët, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

**Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.**

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për efekt të amortizimit të pasurisë së paluajtshme (ndërtesa), Këshilli i Ministrave specifikon gjithashtu edhe nënkategoritë përkatëse.

*Shkalla e taksës mbi ndërtesat e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:*



Tabela 1

Kategoritë e Ndërtesave	Lekë/m <sup>2</sup> me Ligjin nr.9632 me #	Bëhet me Ligjin nr.106/2017
Për ndërtesat që përdoren, shfrytëzohen për banim	2.5-lekë/m <sup>2</sup> -para 1993 3-lekë/m <sup>2</sup> -pas 1993 5-lekë/m <sup>2</sup> -para 1993 Maliq 6-lekë/m <sup>2</sup> -pas 1993 Maliq	0.05%
Për ndërtesa që përdoren, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike.	200 lekë/m <sup>2</sup> – Maliq 100 lekë/m <sup>2</sup> – Njësi 100 lekë/m <sup>2</sup> -Prodhimi Maliq 50 lekë/m <sup>2</sup> – Prodhimi Njësi 40 lekë/m <sup>2</sup> – Të tjera	0.2%
Per sipërfaqen ndertimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me lejë ndertimi por nuk e ka perfunduar brenda afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të lejes ndërtimit.		30%

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat bashkë me nënkategorizimet është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

## 2. Taksa mbi truallin

“**Truall**” është një sipërfaqe toke, jobujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Tabela 2.

Kategoritë e Truallit	Niveli i Taksës në lekë/m <sup>2</sup> në vit
Truall që përdoret për qëllime banimi.	0.14
Truall që përdoret për veprimtari ekonomike	12

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për qëllime biznesi është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

## 3. Taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë, Formulari nr.6, Akti i marrjes në pronësi, çertifikata e regjistrimit të tokës. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë Bashkisë ku ndodhet toka.

Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.



Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon :

Tabela 3.

Kategoritë e tokës bujqësore	Niveli i taksës sipas Ligjit	Niveli i taksës i propozuar
Kategoria 1	4200	2940
Kategoria 2	3500	2450
Kategoria 3	2800	1960
Kategoria 4	2300	1610
Kategoria 5	1900	1330
Kategoria 6	1600	1120
Kategoria 7-10	1400	980

#### 4. Taksa e tabelës

Taksa e tabelës aplikohet për subjektet tregëtare që ushtrojnë veprimtari nën juridiksionin e Bashkisë Maliq dhe vendosin emërtimin/emrin apo çdo të dhënë tjetër, në njësinë ku ata zhvillojnë aktivitet apo jashtë saj. Baza e taksës së tabelës është çdo tabelë e standartizuar, ku identifikohet emri dhe aktiviteti i subjektit fizik apo juridik. Taksa e tabelës paguhet nga çdo person fizik e juridik dhe për çdo njësi apo filial.

Aneksi 7

#### TAKSA E TABELËS SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE

Nr	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	Bashki Kat.I	Bashki Kat.II	Bashki Kat.III
I.	Taksë table për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)				
a	deri në 2 m <sup>2</sup>	lekë/m <sup>2</sup> /vit	0	0	0
b	-mbi 2 m <sup>2</sup> deri 10 m <sup>2</sup>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	15 000	10 000	7 000
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	20 000	15 000	11 500
	-elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	35 000	20 000	15 000
c	mbi 10 m <sup>2</sup> deri 20 m <sup>2</sup>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	12 750	8 500	5 950
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	17 000	12 750	9 775
	-elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	29 750	17 000	12 750
ç	mbi 20 m <sup>2</sup> deri 40 m <sup>2</sup>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	8 250	5 500	3 850
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	11 000	8 250	6 325
	-elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	19 250	11 000	8 250
d	mbi 40 m <sup>2</sup>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	6 000	4 000	2 800
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	8 000	6 000	4 600
	-elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	14 000	8 000	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim				
	-Tabela identifikuese	lekë/m <sup>2</sup> /vit	120	120	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme		Bashkia Tiranë	Bashkia Durrës dhe gjithë bashkitë e tjera të Kat.II	Bashkitë e Kat.III
	-e thjeshtë (me/pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	45 000	22 500	13 500
	-Elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	90 000	45 000	27 000
IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.				
	-të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	1 000	1 000	1 000

Shënim: Bashkitë sipas kategorive ndahen:

Kategoria I: Tiranë, Durrës

Kategoria II: Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë, Berat, Korçë, Pogradec, Sarandë, Lushnjë, Gjirokastrë, Lezhë, Krujë

Kategoria III: Të gjithë bashkitë e tjera

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m<sup>2</sup>, shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m<sup>2</sup> do t'i shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10 m<sup>2</sup> të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.sh., një tabelë të thjeshtë 15 m<sup>2</sup>, shuma e taksës vetore do të llogaritet: (10 m<sup>2</sup> x 15 000 lekë) + (5 m<sup>2</sup> x 12 750 lekë) = 150 000 + 63 750 = 213 750 lekë në vit (ose 17 812 lekë/muaj). E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m<sup>2</sup> dhe mbi 40 m<sup>2</sup>.

Paketa fiskale për vitin 2018 – Bashkia Maliq



## **5. Taksa e fjetjes në hotel**

Me "Hotel" do të kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin njërin ose disa nga emërtimet së bashku: hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim, pavarësisht emërtimit që mban.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Tabela 4.

Kategorite e Hoteleve	Niveli i taksës lekë/natë fjetje
Hotel 2-3 yje	70
Njësi Akomoduese	35

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

## **6. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës.

Tabela 5.

Kategoritë e Ndërtesave	Niveli i taksës lekë/m <sup>2</sup>
Ndërtesa Banimi	100
Ndërtesa për tregëti e shërbime	300
Ndërtesa të tjera	200

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në rolin e agjentit tatimor, të cilat përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit të Bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës

## **7. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura**

Baza e taksës është lloji i mjetit të transportit rrugor. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit.

E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. 25% (njëzet e pesë %) e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në rolin e agjentit tatimor, të cilat përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit të Bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.



## 8. Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare

Bazë e taksës janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i liçencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka.

*Strukturat e ngarkuara për arkëtimin e kësaj takse janë degët e doganave në rrethe në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa Drejtoritë Rajonale të Tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare Brenda vendit nga ku 5 % (pese %) e të ardhurave nga renta minerare kalojnë nëpërmjet Degës së Thesarit, në llogarinë e Bashkisë Maliq.*

## 9. Taksa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV kabllor, Internet).

Baza e taksës për linjat ajrore dhe nëntokësore është gjatësia lineare për kilometër e linjave ajrore dhe nëntokësore e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksa paguesit duke shumëzuar bazën e taksës (gjatësinë lineare për kilometër) me nivelin tregues të saj.

Niveli i taksës së përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7.

Kategoritë e Ndërtesave	Niveli i taksës lekë/km
A. Linja ajrore (telefoni, energji, Tv kabllor, internet)	1500
B. Linja nëntokësore (telefoni, energji, Tv kabllor, internet)	3000

## 10. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Tabela 6.

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës në %
1. Objekte me karakter publik	1%
2. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik	4%
3. Ndërtime të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër.	2%
4. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshi makineritë dhe paisjet në këto projekte	0.1% - Por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
5. Ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0.5%

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë bashkë me nënkategorizimet është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Maliq.*

*Paketa fiskale për vitin 2018 – Bashkia Maliq*



## **11. Të ardhurat nga taksat e ndara**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre, sipas përcaktimeve të nenit 25 Ligji 68/2017.

Dy nga Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

1. Tatimi mbi të ardhurat personale.
2. Tatimi i thjeshtuar i fitimit mbi Biznesin e vogël

Në rastin e Tatimit mbi të ardhurat personale **2%** (dy %) e totalit të arketimeve i kalojnë Bashkisë në territorin e të cilës ushtrojnë aktivitetin/jetojnë personat e tatuar.

Në rastin e Tatimit të thjeshtuar të fitimit mbi biznesin e vogël baza e taksës është **5%** (pesë%).

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e këtyre taksave janë Drejtoritë Rajonale Tatimore të cilat në rolin e agjentit tatimor, janë ngarkuar me vlerësimin, kontrollin dhe arkëtimin e këtyre taksave. Drejtoritë Rajonale Tatimore transferojnë në llogari të buxhetit të qeverisjes vendore shumat e percaktuara me ligj jo më vonë se dt. 30 e muajit pasardhës. Ngarkohet Drejtoria e Tatim Taksave pranë Bashkisë Maliq për të ndjekur rakordimin me Drejtoritë Rajonale Tatimore.*

## **II- TARIFAT VENDORE**

Ky kapitull trajton tarifatat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

Llojit të shërbimit, nivelit të tarifës bazuar në koston e shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Për përcaktimin sa më të drejtë të vlerës së tarifave për shërbimet e ofruara Bashkia Maliq e ka ndarë territorin në tre Zona:

**Zona 1** – Qyteti Maliq/rrethinat

**Zona 2** – Njësitë Pojan, Libonik, Vreshtas, Pirg

**Zona 3** – Njësitë Gorë, Moglicë

### **1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave**

**Përkufizimi:** Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Maliq dhe Njësisve të saj Administrative.

Tabela 8.

Kategoritë	Zona 1 (lekë/vit)	Zona 2 (lekë/vit)	Zona 3 (lekë/vit)
Familjarë	1500	1500	600
Ambulantë	2500	2000	1000
<b>BV (0 – 2 mil)</b> – Njësi Tregëtare dhe Shërbimi	6000	6000	3000
<b>BV/TVSH (2 – 8 mil)</b> – Njësi Tregëtare dhe Shërbimi	10000	8000	5000
Restorant, Furrë Buke, Baxho, Mobileri, Alumine, Supermarket	15000	15000	15000
Tregëti materiale ndërtimi, inerte, mermere, plehera kimik	20000	20000	20000
<b>BM/TVSH (mbi 8 mil)</b> – Njësi Tregëtare dhe Shërbimi	40000	40000	40000
Karburante, Magazina frigoriferike, Pulari, Lloto, TV kabllor	50000	50000	50000
Kompani Ndërtimi, Hidrocentrale, Gurore	100000	100000	100000



<i>Kompani me TVSH jo rezidenciale, por që krijojnë kantiere ndërtimi/punime në Bashkinë Maliq (në proporcion të drejte me afatin e lejes së ndërtimit)</i>	100000	100000	100000
<i>Ujësjetes sh.a, Banka, OSHE, Qendra Shëndetësore, Posta Shqiptare, Sigurimet Shoqërore, Komisarati i Policise, Landfildi Shërbime juridike, ekonomike, shëndetësore, Farmaci/bujqësore</i>	40000	30000	15000
<i>Fondacione , OJQ, OJF</i>	20000	17000	15000
<i>Trasport Udhëtarësh (Kur subjekti është i licencuar si i tillë) – 1+4 / 1+6 / 1+8</i>	10000	8000	6000
<i>Trasport Udhëtarësh (Kur subjekti është i licencuar si i tillë) - Autobusë</i>	5000	4000	3000
<i>Trasport Malli (Kur subjekti është i licencuar si i tillë) - deri 3 ton</i>	9000	8000	7000
<i>Trasport Malli (Kur subjekti është i licencuar si i tillë) – mbi 3 ton</i>	6000	5000	4000
<i>Trasport Malli (Kur subjekti është i licencuar si i tillë) – mbi 3 ton</i>	8000	7000	6000

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq si dhe Zyrat e Taksave pranë Njësive Administrative.

## 2. Tarifa e ndriçimit

Subjekte të tarifës së ndriçimit janë familjarët e regjistruar me banim Bashkinë Maliq, ashtu edhe personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Maliqit.

Tabela 9.

Kategoritë	Zona 1 (lekë/vit)	Zona 2 (lekë/vit)	Zona 3 (lekë/vit)
<b>Familjare</b>	700	600	200
<b>BV (0 – 2 mil)</b> – Njësi Tregëtare dhe Shërbimi	1500	1000	500
<b>BV/TVSH (2 – 8 mil)</b> – Njësi Tregëtare dhe Shërbimi	2000	1500	1000
<b>BM/TVSH (mbi 8 mil)</b> - Njësi Tregëtare dhe Shërbimi, Institucione	6000	5000	4000
<i>Kompani me TVSH jo rezidenciale, por që krijojnë kantiere ndërtimi/punime në Bashkinë Maliq (në proporcion të drejte me afatin e lejes së ndërtimit)</i>	10000	10000	10000

- Përfshihen nga pagesa e tarifës së ndriçimit përkohësisht fshatrat ku nuk ofrohet ky shërbim.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndriçimit është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq si dhe Zyrat e Taksave pranë Njësive Administrative.

## 3. Tarifa e gjelbërimit

Subjekte të tarifës së gjelbërimit janë familjarët e regjistruar me banim Bashkinë Maliq, ashtu edhe personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Maliqit.





Tabela 10.

Kategoritë	Zona 1 (lekë/vit)	Zona 2 (lekë/vit)	Zona 3 (lekë/vit)
<b>Familjarë</b>	100	50	0
<b>BV (0 – 2 mil)</b> – Njësi Tregëtare dhe Shërbimi	900	700	500
<b>BV/TVSH (2 – 8 mil)</b> – Njësi Tregëtare dhe Shërbimi	1200	1000	800
<b>BM/TVSH (mbi 8 mil)</b> - Njësi Tregëtare dhe Shërbimi, Institucione	4000	4000	4000
<i>Kompani me TVSH jo rezidenciale, por që krijojnë kantierë ndërtimi/punime në Bashkinë Maliq (në proporcion të drejte me afatin e lejës së ndërtimit)</i>	8000	8000	8000

- Përfshihen nga pagesa e tarifës së gjelbërimit përkohësisht fshatrat ku nuk ofrohet ky shërbim.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së gjelbërimit është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq si dhe Zyrat e Taksave pranë Njësive Administrative.

#### 4. Nivelet e tarifës për shërbimin në fushën e transportit

Këto tarifa arkëtohen përpara dhënies së licencës apo autorizimit nga Drejtoria e Tatim Taksave. Gjithashtu subjekti para kryerjes së kërkesës për Licencim duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të jetë pajisur me vërtetim nga kjo drejtori. Në çdo rast kërkesë nga ana e subjekteve, këta të fundit pajisen me licencë apo autorizim nga Drejtoria ku përcaktohen të dhënat përkatëse. Niveli i tarifës për shërbimin në fushën e transportit. Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese sipas llojshmërisë së licencave e çertifikatave janë të shprehura si më poshtë:

Tabela 11.

Tarifat e licencimit të transportit të udhëtarëve	Njësia	Tarifa
Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	lekë/linjë/5 vjet	40000
Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	lekë/mjet/vit	1000
Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	lekë/linjë/5 vjet	20000
Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	lekë/mjet/vit	1500
Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	lekë/linjë/5 vjet	75000
Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	lekë/mjet/vit	1500
Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	lekë/linjë/5 vjet	75000
Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	lekë/mjet/vit	1500
Licencë për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	lekë/licencë/5 vjet	15000
Licencë për agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh	lekë/licencë/5 vjet	40000
Licencë për transport udhëtarësh me taksi	lekë/licencë/5 vjet	20000
Libri i udhëtimit për shërbimet e rastit të udhëtarëve brenda vendit (nr.fletëve/nr.udhëtimeve 10)	lekë/libër	5000
Autorizim i përkohshëm një mujor	lekë/autorizim	2000



Tarifat e licencimit të transportit të mallrave	Njësia	Tarifa
Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	lekë/liçence/5 vjet	40000
Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	lekë/ton/kapacitet	100x*
Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet	lekë/ton/kapacitet	100x*
Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshme Brenda vendit (për të tretë dhe me qira ose për llogari të vet)	lekë/ton/kapacitet	100x*
Çertifikatë për tërheqës	lekë/mjet/vit	1500
Çertifikatë për mjete teknologjike	lekë/mjet/vit	1500
Vërtetim për ndryshim orari në linjat e miratuara	lekë/linjë	1000

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së liçencimit është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq si dhe Policia Bashkiake.*

### 5. Tarifa e parkimit të automjeteve

Tarifa e parkimit të automjeteve është detyrim i çdo individi/person fizik apo juridik i cili parkon në vendet e miratuara si “Parkim me Pagesë”.

*Tabela 12.*

Tarifa e Parkimit	Njësia	Tarifa
Mjete transporti udhëtarësh – Vetura 1+4	lekë/mjet/vit	3000
Mjete transporti udhëtarësh – Furgona 1+6 / 1+8	lekë/mjet/vit	5000
Mjete transporti udhëtarësh - Autobusa	lekë/mjet/vit	7000
Mjete transporti malli – Kapacitet deri në 2 ton	lekë/mjet/vit	3000
Mjete transporti malli – Kapacitet mbi 2 ton	lekë/mjet/vit	6000
Mjete transporti udhëtarësh nga Bashkitë e tjera	lekë/orë/qëndrimi	50
Tarifë vjetore për parkim të rezervuar subjekte fizik/juridik	lekë/mjet/vit	15000
Tarifë vjetore për parkim të rezervuar subjekte me TVSH jo rezident	lekë/mjet/vit	30000

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së parkimit është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq si dhe Policia Bashkiake.*

### 6. Tarifë administrative

Tarifës administrative i nënshtrohen të gjitha subjektet fizikë apo juridikë, të regjistruar pranë zyrave të taksave. Niveli i tarifës administrative është **200 lekë në vit** për çdo subjekt të regjistruar apo adresë të regjistruar.

Afati i pagesës së kësaj tarife është së bashku me tarifat e tjera.

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës administrative është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq si dhe Zyrat e Taksave pranë Njësive Administrative.*

*Paketa fiskale për vitin 2018 – Bashkia Maliq*



## 7. Tarifë për dhënie liçenca për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj

Dhënia e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga Bashkia Maliq, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territor të saj.

Tabela 13.

Lloji i liçencës	Njësia	Tarifa
Dhënie dhe përsëritje e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante	lekë/liçenc/5 vjet	1000000
Dhënia e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë	lekë/liçenc/5 vjet	100000

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës administrative është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq.*

## 8. Tarifa e amortizimit rrugor nga mjetet e rënda.

Tarifës së amortizimit rrugor nga mjetet e rënda i nënshtrohen të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet në shfrytëzimin e burimeve natyrore, minerareve, guroreve, porte, diga, etj. të ngjashme. Këta subjekte për automjetet e tyre me tonazhe të rënda mbi 10 ton (sipas tonazhit të përcaktuar në Lejën e Qarkullimit) paguajnë tarifën e amortizimit rrugor, për kalimin në rrugët e qendrave të Njësive Administrative si dhe të qytetit të Maliqit.

Tabela 14.

Lloji i autorizimit	Njësia	Tarifa
Tarifë për transport malli me kapacitet mbi 10 ton	Lekë/autorizim/ditë	500
Tarifë për transport malli me kapacitet mbi 10 ton	Lekë/autorizim/muaj	1000
Tarifë për transport malli me kapacitet mbi 10 ton	Lekë/autorizim/vit	8000

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës administrative është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq si dhe Policia Bashkiake.*

## 9. Tarifa të ndryshme

Tabela 15.

Tarifa për zënien e hapësirave publike	Njësia	Tarifa
Për qytetin e Maliqit	lekë/m <sup>2</sup> /muaj	60
Për Njësitë Administrative	lekë/m <sup>2</sup> /muaj	30
Për vendosjen e tavolinave jashtë lokaleve	lekë/tavolinë/ditë	30
Tarifa e tregut të lirë (Bashkia Maliq + Njësitë Administrative)	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	30
Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit në qytetin e Maliqit	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	60
Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit në Njësitë Administrative	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	30
<b>Tarifë për të drejtën e përdorimit të pronës publike vendore</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>

*Paketa fiskale për vitin 2018 – Bashkia Maliq*



Dhënie me qira të objekteve për qëllim banimi	lekë/m2/muaj	50
Dhënie me qira të objekteve për qëllim biznesi	lekë/m2/muaj	75
Dhënie me qira e Stadiumit	lekë/ndeshje	10000
Dhënie me qira për aktivitet e sallës së Këshillit Bashkiak	lekë/ditë	10000
<b>Tarifa për aktivitete kulturore e sportive</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>
Biletë për hyrje në Stadium	lekë/ndeshje	50
Biletë për shfaqje kulturore për fëmijë	lekë/shfaqje	50
Biletë për shfaqje premiere	lekë/shfaqje	100
Biletë për hyrje ne Pylli i Fazanëve për fëmijë nën moshën 12 vjeç	lekë/person	Falas
Biletë për hyrje ne Pylli i Fazanëve për të rritur	lekë/person	50
Biletë për hyrje ne Pylli i Fazanëve për grupe të organizuara shkollash	lekë/person	20
<b>Tarifë për sistemin e vaditjes së tokave bujqësore</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>
Për vaditje me rrjedhje të lirë	lekë/ha	3000
Për vaditje me ngritje mekanike	lekë/ha	2000
Tarifë për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kullues/vaditës (Zonat 1+2)	lekë/familje/vit	100
<b>Tarifa për kullotat</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>
Të imta për banorët vendas	lekë/krerë/vit	100
Të imta për të ardhurit nga zonat e tjera	lekë/krerë/vit	200
Gjedhe për banorët vendas	lekë/krerë/vit	500
<b>Tarifë për drutë e zjarrit në pyje komunale</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>
Për banorët vendas	lekë/10mst/vit	1000
Për të tjerë	lekë/mst/vit	300
<b>Tarifë për mjetet korëse</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>
Për mjetet brenda Bashkisë Maliq	lekë/mjet/vit	5000
Për mjetet jashtë Bashkisë Maliq	lekë/mjet/vit	10000
<b>Tarifë për dhënie leje 24 orë</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>
Për Kazinotë, Lloto	lekë/vit	50000
Për Karburante, Bar Restorante	lekë/vit	15000
Tarifë për mirëmbajtjen e varrezave	lekë/familje/vit	100

Tabela 16.

<b>Tarifa për shërbimet në Bashki</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>
Për lëshim vërtetimi të thjeshtë për punonjës/familjarë	lekë/copë	50
Për lëshim vërtetimi të thjeshtë për subjekte fizik/juridik	lekë/copë	500
Për vërtetim pensioni	lekë/copë	500
Për nxjerrje dokumenti nga arkivi deri në 15 fletë	lekë	500
Për nxjerrje dokumenti nga arkivi mbi 15 fletë	lekë	1000
Për vërtetime tenderi ose ankandi	lekë/copë	2000
Për vërtetime për shërbime konsullore jashtë Shqipërie	lekë/copë	500
Për lëshim vërtetimi për formularin 6 për në hipotekë	lekë/copë	500
Për lëshim vërtetimi për sigurimet shoqërore	lekë/copë	100



Për lëshim vërtetimi për ndihmën ekonomike	lekë/copë	50
Për lëshim vërtetimi për dokument pronësie	lekë/copë	50
Për lëshim vërtetimi për kufi pronash + skicë	lekë/copë	2000
Konfirmim konflikt pronash	lekë/rast	500
Tarifë therje bagëtie te imët	lekë/krerë	100
Tarifë therje gjedhë	lekë/krerë	150
<b>Tarifa për shërbimet e kontrollit e zhvillimit të territorit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa</b>
Vërtetim pronësie për brenda dhe jashtë Shqipërie	lekë/copë	1000
Vërtetim i thjeshtë shoqëruar me fotokopje nga arkivi	lekë/copë	500
Tërheqje dokumentash të njehësuar me origjinalin	lekë/dosje	500
Pranim dosje për shqyrtim për aplikim leje për objekt banimi	lekë/dosje	3000
Pranim dosje për shqyrtim për aplikim leje për objekt biznesi	lekë/dosje	8000
Pranim dosje për shqyrtim për aplikim për shtesë ne objekti egzistues	lekë/dosje	2000
Kërkesë për prishje objekti	lekë/rast	1000
Kërkesë për shtyrjen e afatit të lejës së ndërtimit për objekt banimi	lekë/rast	1000
Kërkesë për shtyrjen e afatit të lejës së ndërtimit për subjekte juridike	lekë/rast	5000
Njoftim për fillimin e punimeve	lekë	1000
Njoftim për raportin final të mbikqyrjes / kolaudimit	lekë	1000
Njoftim për ndryshim të subjektit zvillues / zbatues	lekë	1000
Pranim plan vendosje për lidhjen e energjisë elektrike	lekë/dosje	1000
Autorizim për riparim çatie	lekë/rast	3000
Autorizim për riparim muri rrethues	lekë/rast	3000
Autorizim për mirëmbajtje të jashtëme ose të brendëshme të ndërtesave	lekë/rast	2000
Për lëshim vërtetimi për kufi pronash + skicë	lekë/copë	2000
Punime të tjera	lekë/rast	5000
Akt kontrolli i piketimit të objekteve – deri 3 kate mbi tokë	lekë	500
Akt kontrolli i piketimit të objekteve – mbi 3 kate mbi tokë	lekë	1000
Akt kontrolli pas përfundimit të themeleve – deri 3 kate mbi tokë	lekë	500
Akt kontrolli pas përfundimit të themeleve – mbi 3 kate mbi tokë	lekë	1000
Akt kontrolli të sistemimeve të jashtëme – deri 3 kate mbi tokë	lekë	500
Akt kontrolli të sistemimeve të jashtëme – mbi 3 kate mbi tokë	lekë	1000
Akt kontrolli pas përfundimit të punimeve – deri 3 kate mbi tokë	lekë	500
Akt kontrolli pas përfundimit të punimeve – mbi 3 kate mbi tokë	lekë	1000
Leje Përdorimi	lekë/m2	30
Tarifë për leje zhvillimi	lekë/rast	1000

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave të ndryshme janë Drejtoritë respektive pranë Bashkisë Maliq.*

*Paketa fiskale për vitin 2018 – Bashkia Maliq*



### III- LEHTËSIRA FISKALE

Shërbime të ofruara nga administrata që përfshijnë: lëshimin e vërtetimeve, tërheqje dokumentacioni nga arshiva apo zyra të tjera, do të kryhen falas për të gjitha kategoritë e mëposhtme :

- a- Invalidët e punës dhe të luftës me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë dhe të aftë për punë.
- b- Të sëmurët tetraplegjikë, paraplegjikë, të verbërit me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë
- c- Pensionistë në rastin kur janë të vetëm në trungun familjar
- d- Personat në ndihmë ekonomike me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë

- Kjo kategori përjashtohet nga taksa e ndërtesës

**Baza ligjore :** Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2010 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 21, pika 5 a).

**Shënim:** Të gjithë taksapaguesit të cilët janë debitorë për taksën e tokës bujqësore ndaj Bashkisë Maliq, do përfitojnë 30% ulje të këtij detyrimi nëse kryhen pagesën e plotë të debisë brenda dt. 31/03/2018. Në rast mospagese brenda këtij afati, detyrimi do të kërkohet i plotë sipas Ligjit në fuqi. Nuk përfitojnë ulje detyrimet e vitit 2016-2017.

### IV-GJOBAT

Gjobat do të aplikohen në rastet e kundravajtjeve administrative apo shkeljeve ligjore të ndryshme brenda territorit të administruar nga Bashkia Maliq. Përgjegjëse për aplikimin dhe vjeljen e këtyre gjobave do të jenë zyrat/drejtoritë të cilat i kanë nën administrim në bashkëpunim me strukturat e Policisë Bashkiake.

#### 1. Gjoba për mosshlyerje në afat të detyrimit

Gjobat aplikohen vetëm për subjektet e tatueshme (që kanë detyrim pajisjen me NIPT). Afati i fundit për likuidimin e detyrimit vjetor të vitit aktual është data 31 dhjetor i këtij viti. Baza e llogaritjes së gjobës për mosshlyerje përfshin detyrimet totale të gjithë vitit aktual që lindin nga tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, tarifa e shërbimeve, taksa e tabelës për qëllime identifikimi, taksa e ndërtesës ,taksa e truallit, etj., sipas faturës për pagesë. Subjektet e reja si dhe adresat sekondare të çelura rishtazi kanë afat deri në 31 dhjetor për shlyerjen e detyrimit..

Tabela 17.

Kategoritë	Njësia	Niveli i gjobës
Gjoba për mosshlyerje të detyrimeve tatimore (taksa, tarifa) brenda vitit.	% / ditë vonesë (jo më shumë se 365 ditë kalendarike)	0.06

Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe mbledhjen e këtyre gjobave është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.



## 2. Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundrvajtjet administrative

Zbatimi i gjobave të paraqitura në tabelën 33, u ngarkohet të gjitha drejtorive përkatëse në bashkëpunim me Sektorin e Policisë Bashkiake.

Përjashtohen nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara me ligj të veçantë.

Tabela 18.

Lloji i kundërvajtjes së kryer	Masa e Gjobës/lekë
Për dëmtim, çarje dhe ndotje rruge	10000
Për dëmtim, çarje, ndotje trotuari	10000
Për dëmtim bordure	10000
Për dëmtim, rrjetit të kanalizimeve, bllokim pusete	10000
Për vjedhje kapak pusete	10000
Lidhjet e pamiratuara në rrjetin ajror	20000
Dëmtimi i ndriçuesve të qytetit	20000
Perdorim i shtyllave si support për montimin e reklamave, kapjen e kabllave etj	5000
Lidhjet e pamiratuara në tubacionet e ujit	10000
Dëmtim i rjetit nga punimet që kryhen pranë tyre me lejë ose pa lejë	10000
Mospajisje me leje veprimtarie për transport udhëtarësh 1+4 / 1+6 / 1+8	10000
Mospajisje me leje veprimtarie për transport udhëtarësh Autobuza	20000
Mospajisje me leje veprimtarie për tregëtimin me shumicë e pakicë të karburanteve	30000
Mospajisje me leje veprimtarie për ambulante, kantine	2000
Mospajisje me leje veprimtarie 24 orëshe	15000
Mospajisje me leje për zënien e hapësirave publike	10000
Mospajisje me leje për vendosje reklame të thjeshtë	5000
Mospajisje me leje për vendosje reklame elektronike	15000
Hyrja pa autorizim i mjeteve me tonazh të lartë në qendrat e Bashkisë	15000
Hedhje e mbeturinave jashtë vendeve të përcaktuara nga Bashkia Persona fizik	5000
Hedhje e mbeturinave jashtë vendeve të përcaktuara nga Bashkia Persona juridik	10000
Për të gjithë ata që bllokojnë kanalet kullues apo vaditës me ndërtime të paligjshme të çfarëdo lloji	20000
Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta	5000
Dëmtim / prerje e pemëve	10000
Zëni e hapësirës së gjelbërt pa leje	5000
Vendosje pankartash, banderola, postera pa leje	10000
Mos ndërtimi i bazamenteve të kontenierëve për mbetjet urbane të subjekteve të ndërtimit për objekte mbi 5 kate	10000
Zëni e tokës bujqësore, pyje e kullota	10000
Ndotje e mjedisit nga plehëra, ujërat e zeza etj	5000
Për tregëtimin e mishit të therur të pa çertifikuar nga Inspektoriati	5000
Për ndotje të hapësirës publike jashtë rrethimit të kantierit të ndërtimit nga inerte	10000
Për çdo dëmtim të fasadës	10000

Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe mbledhjen e këtyre gjobave është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe Policia Bashkiake pranë Bashkisë Maliq

KRYETARI I KËSHILLIT  
ERISELD JONUSLLARI

Paketa fiskale për vitin 2018 - Bashkia Maliq



## Bashkia Maliq

### Plani i te Ardhurave per vitin 2018 sipas zerave i ndare ne muaj

Nr	Emertimi	Totali	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	<b>Te ardhura tatimore</b>													
	Taks Ndertese	19138200	1794449	1794449	1794449	1794449	1794449	1794449	1794449	1794449	1794761	995949	995949	995949
	Familjare	11951600	995949	995949	995949	995949	995949	995949	995949	995949	996161	995949	995949	995949
	Familje 2018	3404600	283700	283700	283700	283700	283700	283700	283700	283700	283900	283700	283700	283700
	Familjare 2017	2000000	166666	166666	166666	166666	166666	166666	166666	166666	166674	166666	166666	166666
	Familjare 2016	667000	55583	55583	55583	55583	55583	55583	55583	55583	55587	55583	55583	55583
	Familjare 2006-2015	5880000	490000	490000	490000	490000	490000	490000	490000	490000	490000	490000	490000	490000
	Biznese	7186600	798500	798500	798500	798500	798500	798500	798500	798500	798600			
2	<b>Takse Trualli</b>	2885459	294066	294066	294066	294066	294066	294066	294066	294066	294077	79618	79618	79618
	Familje	955427	79618	79618	79618	79618	79618	79618	79618	79618	79629	79618	79618	79618
	Familje 2018	395427	32952	32952	32952	32952	32952	32952	32952	32952	32955	32952	32952	32952
	Familje 2017	210000	17500	17500	17500	17500	17500	17500	17500	17500	17500	17500	17500	17500
	Familje 2016	350000	29166	29166	29166	29166	29166	29166	29166	29166	29174	29166	29166	29166
	Biznese	1930032	214448	214448	214448	214448	214448	214448	214448	214448	214448			
3	<b>Takse Toke</b>	73675541	6139627	6139627	6139627	6139627	6139627	6139627	6139627	6139627	6139644	6139627	6139627	6139627
	Takse Toke 2018	25194500	2099541	2099541	2099541	2099541	2099541	2099541	2099541	2099541	2099549	2099541	2099541	2099541
	Taks Toke 2017	18000000	1500000	1500000	1500000	1500000	1500000	1500000	1500000	1500000	1500000	1500000	1500000	1500000
	Taks toke 2016	15423000	1285250	1285250	1285250	1285250	1285250	1285250	1285250	1285250	1285250	1285250	1285250	1285250
	Takse Toke 2006-2015	15058041	1254836	1254836	1254836	1254836	1254836	1254836	1254836	1254836	1254845	1254836	1254836	1254836
4	Takse Tabele	497000	82833	82833	82833	82833	82833	82835						
5	Takse Tregu	600000	50000	50000	50000	50000	50000	50000	50000	50000	50000	50000	50000	50000
6	Legalizimet	8400000	700000	700000	700000	700000	700000	700000	700000	700000	700000	700000	700000	700000
7	Ndertime te reja	3000000	333333	333333	333333	333333	333333	333333	333333	333333	333336			
8	Tatimi i Thjeshtuar	1000000	83333	83333	83333	83333	83333	83333	83333	83333	83337	83333	83333	83333
9	Te ardhura nga DRTSH	8550000	712500	712500	712500	712500	712500	712500	712500	712500	712500	712500	712500	712500
10	T. Rentes minerale	550000	45833	45833	45833	45833	45833	45833	45833	45833	45837	45833	45833	45833
11	Takse nga ZRPP	50000			12500			12500			12500			12500
12	Kontrata Qeraje	11428000	952333	952333	952333	952333	952333	952333	952333	952333	952337	952333	952333	952333
13	Tatim mbi TAP	5600000	466666	466666	466666	466666	466666	466666	466666	466666	466674	466666	466666	466666





16	Tarife per zenien e hapësirave publike	100000	11111	11111	11111	11111	11111	11111	11111	11111	11112			
17	Tarifa Administrative	200000	22222	22222	22222	22222	22222	22222	22222	22222	22224			
18	Kazan Rake	50000									50000			
19	T.Leje NONSTOP	100000	100000											
20	Gjoha te #	500000	41666	41666	41666	41666	41666	41666	41666	41666	41674	41666	41666	41666
	<b>SHUMA II</b>	<b>155625800</b>	<b>7797583</b>	<b>7697583</b>	<b>7747583</b>	<b>7697583</b>	<b>8147583</b>	<b>10547583</b>	<b>10347583</b>	<b>23897583</b>	<b>22747652</b>	<b>21365828</b>	<b>21315828</b>	<b>6315828</b>
	<b>TOTALI I+II</b>	<b>300000000</b>	<b>20952556</b>	<b>20852556</b>	<b>20915056</b>	<b>20852556</b>	<b>21302556</b>	<b>23715058</b>	<b>21919723</b>	<b>35469723</b>	<b>34332655</b>	<b>31591687</b>	<b>31541687</b>	<b>16554187</b>

Për Drejtorinë e të Ardhurave  
Drejtor:  
Gentian Aliçkollli



KRYETARI I BASHKISË  
Z.Gëzim Topçiu


